



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2010

SESIONI I

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme artistike; koreografike; sportive; me kohë të shkurtuar.

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve. Për rastet kur përgjigja e nxënësit nuk përshtatet plotësisht me përgjigjen në skemë, por afron me logjikën e saj, komisioni i vlerësimit këshillohet me drejtuesin teknik dhe specialistin e AVA për vlerësimin përfundimtar të pyetjes.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**DRITËRO AGOLLI****Enigma e maleve**

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	C	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë

Pyetja 8 **1 pikë****Model përgjigjeje:**

***Folja është: rrëqethet**

1 pikë. Nëse nxënësi jep foljen rrëqethet.

0 pikë. Nëse jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 **3 pikë****Model përgjigjeje:**

a/1: Shembuj, që dëshmojnë frymëzimin e poezisë së Agollit nga jeta e përditshme janë:

- **problematika e përditshmërisë,**
- të papriturat në jetë,
- detaje të jetës së përditshme si; bisedat me dhe nën zë.
- marrja me malin,
- **shprehje apo fjalë të tilla** si; *s'merr vesh, leckamanë të vegjël, torba, qoshe,* etj.

a/2: Shembuj, që dëshmojnë frymëzimin e poezisë së Agollit nga krijimtaria popullore janë:

- **efekti ose përdorimi i numrit** (tri).
- **pasuria leksikore** ose fjalori poetik popullor (udha, skuta, driza, qoshe, kulla, çupa, leckamanë, zall).
- elemente **të metrikës** (muzikaliteti dhe rima).
- **fryma e filozofisë së popullit.**

b- Tipari që fiton poezia e Agollit nga ky frymëzim është: **thjeshtësia, natyrshmëria, dhënia e mesazhit në mënyrë të drejtpërdrejtë etj.**

3 pikë. Kur nxënësi thotë një shembull për secilin nga pikat a/1, a/2 dhe jep tiparin e kësaj krijimtarie.

2 pikë. Kur nxënësi thotë vetëm një shembull dhe tiparin ose vetëm dy shembujt.

1 pikë. Kur nxënësi jep vetëm një shembull ose vetëm tiparin.

0 pikë. Për përgjigje të gabuar ose kur nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10**3 pikë****Model përgjigjeje:**

- Efekti stilistik që krijohet është: **përgjithësimi** se askush nuk mund ta gjejë enigmën.
- **Raporti është përjashtues.** Ndërsa në fillim të poezisë, poeti thotë *ti apo pyet kush*, në fund thotë *kurrkush*.
- Fjala *kurrkush* **mban peshën** e këtij përjashtimi.
- Vetë enigma, jo vetëm që është e tillë, jo vetëm që është **enigmë e malit**, ku njeriu e ka të vështirë të futet për ta zbuluar, por kurrkush (**kurrë, asnjë njeri**) nuk ka për ta zbuluar atë. Enigma është **e përjetshme**. Ajo e ka mundur njeriun përjetë dhe do të vazhdojë ta mundojë.

3 pikë. Nëse nxënësi jep efektin stilistik, raportin dhe shpjegon peshën e fjalës *kurrkush* në këtë raport.

2 pikë. Nëse nxënësi jep dy nga tre treguesit e përmendur.

1 pikë. Nëse nxënësi jep njërin nga tre treguesit.

0 pikë. Për përgjigje të gabuar ose kur nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11**3 pikë****Model përgjigjeje:**

a- Poeti e ndesh fillimisht enigmën në: **male (qoshe, skuta, gurë)**. E ndesh te: **(drizat, hardhucat, ketrat)**.

b- Vendet ku ndeshet enigma në poezi më pas, deri në fund të poezisë janë:

kulla, njerëzit, çupat, udha, djemtë, përrenjtë, shpella, për t'u kthyer përsëri te mali.

c- Autori emrin *mal* e ka dhënë në numrin shumë: për t'i dhënë përmasë, për të na dhënë **idenë se enigma është një, por ajo mund të ndodhet kudo.**

3 pikë. Nëse nxënësi jep tri përgjigje sipas pikave a,b,c.

2 pikë. Nëse nxënësi jep dy nga përgjigjet e pikave më lart.

1 pikë. Nëse nxënësi jep një nga përgjigjet e pikave më lart.

0 pikë. Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12**4 pikë****Model përgjigjeje:**

a- Gjatë interpretimit, nxënësi mund të thotë:

- Mali mban enigmën.
- Kjo enigmë është intriguese, plot mister, e padepërtueshme.
- Kjo enigmë merr frymë, gjallon pranë njeriut, por ai nuk e zbulon dot.
- Mali është enigmatik dhe misterioz.
- Raporti i tyre me malin është përjetësia. Përjetë mali është i destinuar t'i ketë me vete enigmën dhe misterin.
- Mali nuk e lëshon enigmën, por vetë enigma gjendet edhe te njeriu.
- Përhapja e enigmës është **si një shkallëzim zbritës fillimisht**, nga mali deri thellë te përrenjtë **dhe më pas në një shkallëzim ngjitës nga zalli deri te shpatet hanxharë etj.**

b/1 shembull shpirtëzimi: personifikimi i enigmës që mbart mali: *enigma në male përgjon në qoshe dhe skuta.*

b/2 kurrkush s'e kupton enigmën e malit/ komplotin e tij të fshehtë e ka frikë ose

misteri jepet nëpërmjet foljeve, që e forcojnë pamundësinë e zbulimit të tij sikundër në shembujt: s'di pse, s'kupton pse, s'merr vesh, çfarë fshihen, të gjithë përemrat pyetës etj.

4 pikë. Nëse nxënësi jep interpretimin e plotë për marrdhënien mal-enigmë dhe sjell dy shembuj nga poezia për këtë.

3 pikë. Nëse nxënësi jep interpretimin e plotë dhe sjell një shembull/ ose sjell dy shembuj dhe jep interpretim të pjesshëm.

2 pikë. Nëse nxënësi jep një shembull dhe interpretim të pjesshëm/ ose vetëm dy shembuj/ ose vetëm interpretimin e plotë.

1 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm një shembull ose vetëm një interpretim të pjesshëm.

0 pikë. Nëse nxënësi nuk jep përgjigje sipas kërkesave më lart ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13**8 pikë****Model përgjigjeje:****13/a Shtjellimi i idesë 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:**

- Përshtatja me qëllimin e temës.
- Përqendrimi te koncepti *mal* dhe *enigmë*.
- Përqendrimi te shpirtëzimi i enigmës, te enigmat njerëzore etj.
- Fokusimi te lidhja ose raportet midis enigmës dhe njeriut, por edhe enigmës dhe natyrës (lidhja mund të shihet te; misteri, zbulimi, mahnitja, mrekullimi, kontrasti, hiperbolizimi, frika etj).
- Mënyra se si argumentohet ky raport (nënkuptohet shpjegimi dhe mbështetja e mendimit me fakte, detaje).
- Formulimi ose përmbledhja koncize e faktit mbi të cilin mbështetet argumenti, mendimi etj.

2 pikë. Kur ka treguesit e mësipërm.

1 pikë. Kur trajton temën përkatëse, por nuk përdor argumentin si element.

0 pikë. Kur nuk shkruan dhe argumenton në lidhje me temën, kur nuk kuptohet asgjë, ose nuk shkruan fare.

13/b Organizimi dhe struktura 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:

- Pjesët përbërëse (hyrje, zhvillim, mbyllje).
- Logjika (të ketë lidhje me çfarë është thënë më pare, të ketë rend të mendimit dhe ideve, fakteve, të shembujve që jepen.)
- Kalimet e kuptimshme (nga pjesa ose fragmenti, rrjedhën argumentuese).
- Renditja e të paktën dy ose tre fakteve për të argumentuar mendimin etj.

2 pikë. Kur nxënësi i plotëson kërkesat e mësipërme.

1 pikë. Kur nxënësi respekton vetëm strukturën formale, por nuk tregon cilësi në ndërthurjen e saj me kuptimin dhe argumentimin.

0 pikë. Kur struktura nuk na jep asnjë kuptim.

13/c Stili dhe origjinaliteti. 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:

- Shprehjet origjinale (fakte, detaje, fjalë jo të zhargonit të përditshëm).
- Nëse stili është i gjallë, tërheqës, ndikues, bindës (me rrjedhshmëri, me efekt bindës).
- Stili ka qartësi. Rendi i fjalëve dhe fjalive (fjalët e renditura në fjali duhet të kenë kuptim dhe të jenë bindëse).
- Stili të jetë jo imitues, (të mbështetet te autori, por nxënësi të japë dhe mendimin e tij me origjinalitet).

2 pikë. Kur ka treguesit e mësipërm.

1 pikë. Kur thotë diçka të vetën, por pa larmi, pa bukuri, pa shumë qartësi.

0 pikë. Kur nuk thotë asgjë ose nuk kuptohet asgjë nga ajo që ka thënë.

13/d Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) 2 pikë**Duhet të kihen parasysh:**

- Trajtat e dhura e fjalëve.
- Fjali të sakta.
- Shenjat e pikësimit.
- Shkronja e madhe.

2 pikë. Kur nxënësi realizon shkrimin argumentues me saktësi drejtshkrimore dhe sintaksore.

1 pikë. Kur ka gabime, por kuptohet se çfarë ka shkruar.

0 pikë. Kur gabimet e shumta deformojnë, ose nuk lejojnë kuptimin e shprehjes.

PJESA II**ERNEST HEMINGUEJ****Plaku dhe deti**

Pyetja 14	B	1 pikë
Pyetja 15	A	1 pikë
Pyetja 16	A	1 pikë
Pyetja 17	C	1 pikë
Pyetja 18	D	1 pikë
Pyetja 19	B	1 pikë

Pyetja 20 **2 pikë****Model përgjigjeje:**

Fjalja ku duket paradoksi është: *Megjithatë, e vrava këtë peshk, që e kam më të shtrenjtë se vëllanë.*

Peshkun ai e konsideron *vëlla* ose *më të shtrenjtë se vëllanë*

2 pikë. Nëse nxënësi jep fjalinë ku duket paradoksi dhe si e quan peshkun.

1 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm fjalinë ose vetëm fjalën vëlla.

0 pikë. Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 **2 pikë****Model përgjigjeje:****Plaku bën rezistencë për dy nga arsyet e mëposhtme:**

- mbijjetesën, ekzistencën.

- krenarinë, sedrën.

ose

- nga dëshira për të fituar.

- ngaqë kurrë nuk e ka pranuar humbjen .

- etj.

2 pikë. Nëse nxënësi jep dy arsye si më sipër.

1 pikë. Nëse nxënësi jep njëren nga arsyet.

0 pikë. Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22**3 pikë****Model përgjigjeje:****a- Fjalja pyetëse përdoret:**

- për të treguar dilemën e plakut
- për ta shtyrë më tej në betejë
- për t'i dhënë forcë
- i shërben si nxitje për veten
- sepse plaku është mësuar të flasë me veten, pyet veten etj.

b- Në fjalinë e dytë plaku vendos se ç'do të bëjë. Vazhdon betejën e tij, duelin e tij. Nuk ka më dilemë, guxon, sfidon etj.

c- Tiparet e plakut: Vullneti, durimi, vendosmëria, rezistenca, këmbëngulja, qëndresa, përvoja etj.

3 pikë. Kur nxënësi jep tri përgjigje sipas pikës (a, b,c).

2 pikë. Kur nxënësi jep dy nga përgjigjet (a, b, c).

1 pikë. Kur nxënësi jep vetëm një nga përgjigjet (a, b, c).

0 pikë. Kur nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23**2 pikë****Model përgjigjeje:****Shpjegimi i nxënësit mbi mendimin e plakut:**

- Shpjegimi duhet t'i referohet duelit, dyluftimit.
- Plaku e ngre peshkun në nivelin e kundërshtarit të denjë.
- Plaku dhe peshku kanë të përbashkët luftën për ekzistencë.
- Në këtë luftë ata dallojnë nga armët e ndryshme që përdorin në duel: plaku (krenarinë, përvojën), peshku (fuqinë) etj.
- Është luftë për jetë a vdekje. Duel do të thotë që njëri nga të dy nuk do të jetojë më.
- Kjo luftë në një kuptim merr fund pikërisht me këtë duel.
- Dueli mund të lidhet edhe me sfidën e plakut, i cili ishte peshkatar me përvojë.

2 pikë. Nëse nxënësi jep shpjegimin e plotë duke u nisur nga kuptimi i duelit.

1 pikë. Nëse nxënësi jep përgjigje të pjesshme ose të paplotë.

0 pikë. Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24**4 pikë****Model përgjigjeje:****a- Në përshkrimin që plaku i bën peshkut përshtypja duhet të lidhet me:**

adhurimin, vlerësimin për peshkun, **të drejtën** që plaku i jep peshkut.

Përshkrimi na çon te **lidhja e veçantë: plak-peshk**. Ai e përshkruan peshkun si mrekullinë e detit, si mrekullinë e luftës së përditshme (e konsideron të barabartë me veten), por edhe si mrekullinë dhe sfidën e jetës së tij.

b- Pjesa e ligjëratës që ndihmon përshkrimin është: mbiemri.**- Shembujt janë: gjigande, të mrekullueshme, të qetë, fisnike.**

4 pikë. Nëse nxënësi jep përshtypjen e plotë rreth përshkrimit dhe tregon pjesën e ligjëratës duke dhënë një shembull.

3 pikë. Nëse nxënësi jep përshtypjen e plotë + pjesën e ligjëratës, përshtypjen e plotë +shembullin, përshtypjen e pjesshme + shembullin+ pjesën e ligjëratës.

2 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm përshtypjen e plotë, vetëm pjesën e ligjëratës me shembullin, vetëm një përshtypje jo të plotë të shoqëruar ose me shembullin ose me pjesën e ligjëratës.

1 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm njërën nga përgjigjet e vlerësimit me katër pikë.

0 pikë. Nëse nxënësi jep përgjigje që nuk ka lidhje me ç'i kërkohet ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25**2 pikë****Model përgjigjeje:****Tipare të stilit të Heminguejit që mund të hasni në këtë fragment janë:**

- tema e luftës për ekzistencë
- monologu, dialogu i brendshëm
- stili sugjestionues
- parimi i ajzbergut
- ekonomia e gjuhës
- etj.

Shpjegimi duhet të lidhet me njërin nga tiparet më lart.

2 pikë. Nëse nxënësi jep një tipar të stilit të Heminguejit dhe e shpjegon konkretizimin e tij në fragment ose në vepër.

1 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm tiparin ose vetëm një shpjegim jo të plotë.

0 pikë. Nëse përgjigja nuk ka lidhje kërkesën ose nxënësi nuk përgjigjet fare.